



Kolegji ESLG

STATUTI
I
KOLEGJIT
ESLG

Gusht 2019

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr.04/L-037 të Republikës së Kosovës Bordi Menaxhues i Kolegjit ESLG më 14.08.2019 nxjerr ndryshimet dhe plotësimet e statutit si në vijim:

STATUTI I KOLEGJIT ESLG

DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1 Institucion i pavarur i arsimit të lartë

Kolegji ESLG (mëtuftje: kolegji) është institucion i pavarur i arsimit të lartë i cili ofron arsimim universitar dhe angazhohet në aktivitete kërkimore, studimore dhe këshilluese në fushën e shkencave shoqërore.

Neni 2 Emri dhe selia e Kolegjit

- (1) Emri i Kolegjit është: Kolegji ESLG. Shkurtesa e Kolegjit është: ESLG.
- (2) Emri ndërkombëtar i Kolegjit ESLG është: College ESLG.
- (3) Selia e Kolegjit është Nazim Gafurri 33, Prishtinë.

Neni 3 Subjektiviteti juridik

Kolegji është subjekt juridik i cili vepron në emër dhe në llogari të vet.

Neni 4 Vula dhe simboli i Kolegjit

- (1) Kolegji ka vulën e vet me përshkrimin BprAL KOLEGJI ESLG.
- (2) Kolegji ka simbolin e vet i cili do të përdoret në të gjitha dokumentet e Kolegjit.
- (3) Kolegji ka vulën në formë të rrumbullakët i cili përmban emrin dhe simbolin e Kolegjit. Kolegji përdor simbolin e vet SUB ROSA të cilin e publikon në të gjitha faqet e internetit të Kolegjit.
- (4) Në aktivitetet ndërkombëtare, Kolegji ESLG përdor vulën College ESLG.

II. AUTONOMIA E KOLEGJIT

Neni 5 Autonomia

Kolegji ushtron autonominë e tij në fushën e arsimit dhe shkencës duke u bazuar në fushën shkencore në veçanti:

1. Ushtron në mënyrë të pavarur veprimtarinë e vet;
2. Nxjerr në mënyrë të pavarur rregullat e organizimit të brendshëm;
3. Harton në mënyrë të pavarur programet e studimit dhe vendos për mënyrën e ofrimit të tyre;
4. Përcakton kriteret për emërimin e profesorëve, hulumtuesve dhe stafit akademik;
5. Vendos për punësimin e profesorëve, punëtorëve shkencor dhe bashkëpunëtorëve profesional.

III. VEPRIMTARIA E KOLEGJIT

Neni 6 Fushëveprimi i aktiviteteve të Kolegjit

Aktivitetet e kolegjit përpos arsimimit të lartë dhe pasdiplomik, aktiviteteve kërkimore në fushën e shkencave juridike, administrative, arkitekturës dhe ndërtimtarisë dhe shkencat tjera shoqërore janë paraqitur në vazhdim:

- 7310 Kërkime, aplikime eksperimentale në shkencat e natyrës, teknikës dhe teknologjisë
- 7320 Hulumtimi dhe zhvillimi eksperimental në shkencat shoqërore dhe ato humane
- 7420 Veprimtaritë e arkitekturës dhe inxhinierisë dhe këshillime në lidhur me to
- 8030 Arsimi i lartë/universitar
- 8042 Arsimi për të rritur dhe arsimimi tjetër
- 9251 Aktivitetet e librarisë dhe arkivës
- 2211 Botimi i librave
- 2212 Botimi i gazetave
- 2213 Botimi i revistave
- 2214 Botimi i inçizimeve të zërit
- 2215 Publikimet tjera
- 2222 Shtypja e materialeve tjera
- 2223 Libërlidhja
- 2224 Përbërja dhe përgatitja e pllakave për shtypje-përgatitja e shtypjes
- 2225 Aktivitetet tjera të ndërlidhura me shtypje
- 4523 Ndërtimi i autostradave, rrugëve, aeroporteve dhe objekteve sportive
- 7411 Aktivitetet ligjore/konsulenca

- 7412 Kontabiliteti dhe auditimi
- 7413 Hulumtimi i tregut dhe anketat e opinionit publik
- 7414 Aktivitetet e konsulencës së biznesit dhe menaxhimit
- 7440 Reklamimi
- 7483 Aktivitetet sekretarike dhe të përkthimit
- 7482 Aktivitetet e paketimit/Shërbimet e kopjimit dhe riprodhimit
- 7484 Aktivitetet tjera të biznesit
- 9112 Aktivitetet e organizatave profesionale
- 9900 Organizatat dhe asociacionet jashtë vendit

Neni 7 **Angazhimi i Kolegjit**

Në zhvillimin e aktiviteteve të tij, Kolegji ESLG angazhohet në aktivitete ndërkombëtare shkencoro-hulumtuese dhe për këtë qëllim angazhohet në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

IV. PRONËSIA E KOLEGJIT

Neni 8

Pronar i Kolegjit ESLG me pronësi prej 100 % është Prof. Dr. Edmond Hajrizi me numër të letërnjoftimit 1030397076, i cili është njëkohësisht edhe Kryetar (President) i Bordit

V. ORGANIZIMI I KOLEGJIT

Neni 9

Organizimi i Kolegjit

Me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të tij, Kolegji është i organizuar bazuar në kërkesat e arsimit të lartë dhe madhësisë dhe fushëveprimit të aktiviteve individuale.

Neni 10

Njësitë dhe veçoritë e Kolegjit

- (1) Njësitë kryesore dhe karakteristikat e organizimit të Kolegjit janë administrata e saj, ndarjet akademike, organet vendim-marrëse, sistemi financiar dhe rendi i saj i akteve të brendshme rregullative.
- (2) Kolegji do të themelojë dhe të mbajë të gjitha njësitë themelore të organizimit të tij në selinë zyrtare të saj akademike dhe administrative në Prishtinë në Republikën e Kosovës.

- (3) Të gjitha elementet dhe tiparet e organizimit të Kolegjit janë të parashikuara në këtë statut në kushtet e përgjithshme dhe do të shtjellohen më tej me aktet nënligjore dhe me aktet e tjera të brendshme rregullative të Kolegjit, që do të vendosen dhe të nxjerren nga Bordi Menaxhues i Kolegjit.

Neni 11

Llojet e njësive organizative

Kolegji mundet të themelojë në kuadër të organizimit të tij shkolla, katedra, departamente, njësi, institute, qendra dhe njësi tjera si Qendra e Librarisë, qendra informative dhe dokumentuese si dhe qendra për studime në distancë dhe klubi i alumneve.

Neni 12

Shkollat

Shkollat janë njësi organizative të cilat themelohen me qëllim të implementimit të programeve studimore të Kolegjit.

Neni 13

Katedrat

Katedrat themelohen në ato fusha të caktuara shkencore me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve kërkimoro-shkencore në disiplinat e caktuara shkencore dhe pedagogjike.

Neni 14

Institetet dhe qendrat

Institetet zhvillojnë aktivitete kërkimore dhe shkencore dhe konsulente në fushat përkatëse.

Neni 15

Libraria botuese e Kolegjit

- (1) Libraria dhe qendra informative dhe dokumentuese e Kolegjit shërben për nevojat studimore dhe hulumtuese të studentëve dhe profesorëve të Kolegjit.
- (2) Me qëllim të zhvillimit të aktivitetit të vet botues, Kolegji ESLG ka librarinë e saj botuese.

Neni 16
Klubi i alumnive

- (1) Klubi i alumnive është një bashkim i të diplomuarve të të gjitha gjeneratave të të gjitha programeve të Kolegjit me qëllim të ruajtjes së lidhjeve dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet të të diplomuarve të Kolegjit të të gjitha fushave.
- (2) Në kuadër të Klubit të Alumnive vepron qendra e karrierës e cila i ndihmon studentëve ekzistues gjatë marrjes së vendimeve për studime, koordinon shkëmbimet ndërkombëtare, këshillon studentët gjatë dizajnit të karrierës dhe përgatit rrugët e karrierës së të diplomuarve të Kolegjit. Puna e klubit të alumnive dhe qendrës së karrierës rregullohet me Rregullore të veçantë të saj.

Neni 17
Puna e njësive organizative

- (1) Njësitet organizative kanë organet e saj të cilat janë të formuara në pajtim me aktivitetet e saj të cilat janë përgjegjëse për veprimtarinë profesionale të këtyre njësive.
- (2) Njësia organizative ka organin e saj kolegjal profesional dhe emërtimi dhe forma e themelimit rregullohet me vendimin mbi themelimin e njësisë organizative e cila merret nga Bordi Menaxhues e cila duhet të jetë në pajtim me aktin inkorporues të Kolegjit dhe statutin e Kolegjit.
- (3) Mjetet financiare për zhvillimin e aktiviteteve edukative-arsimore, këshilluese dhe kërkimore të cilat kryhen në kuadër të njësisë organizative të Kolegjit duhet të pasqyrohen në kuadër të bilanseve individuale të njësive organizative, programeve të studimit dhe projekteve që kryhen në kuadër të kësaj njësie organizative.
- (4) Njësia organizative themelohet dhe shuhet me vendim të Bordit Menaxhues të Kolegjit ESLG. Gjatë themelimit të njësive të reja organizative duhet të specifikohen aktivitetet e njësive të reja organizative dhe struktura e tyre organizative dhe autorizimet përkatëse të njësisë organizative gjatë qarkullimit të saj juridik.

Neni 18
Organet e Kolegjit

- (1) Organet e Kolegjit janë: Bordi Menaxhues, Drejtori, Rektori, Dekani, Këshilli Akademik, Senati, Këshilli i Studentëve, Komisioni i Studimeve, Komisioni i Habilitimit dhe Dhënie të Titujve Akademik, Komisioni Disciplinor dhe Komisioni për Cilësi.

- (2) Kolegji mundet të themelojë edhe organe të tjera në pajtim me statutin dhe me vendim të Bordit Menaxhues.

Neni 19 **Senati**

(1) Senati është organ profesional i kolegjit i cili ka më së paku nëntë anëtarë. Senati përbëhet nga ata anëtarë të këshillit akademik të kolegjit të cilët janë bartës të së paku një lënde të caktuar. Në senat janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë të gjitha disiplinat shkencore dhe fushat profesionale të Kolegjit.

(2) Sipas funksionit të tyre anëtarë të senatit në mënyrë automatike për zgjedhen përfaqësuesit e Këshillit të Studentëve, rektori, dekani dhe prodekanët. Studentët përbëjnë së paku 1/5 e Senatit.

Neni 20 **Mandati i anëtarëve të Senatit**

Anëtarët e senatit zgjedhen nga Këshilli Akademik. Mandati i anëtarëve të senatit është tre vjet dhe pas skadimit të afatit anëtarët e senatit munden të rizgjedhen.

Neni 21 **Udhëheqja e senatit**

Punën e senatit e udhëheq Rektori, Dekani dhe në mungesë të të dyve seancat e senatit i udhëheq anëtari i autorizuar i senatit.

Neni 22 **Kompetencat e senatit**

- (1) Senati vendos për të gjitha çështjet e implementimit të programeve ekzistuese të studimit, programeve të reja dhe ndryshimeve në programet ekzistuese.
- (2) Vendimet e senatit që kanë të bëjnë me përcaktimin e numrit të studentëve në rast të numrit të kufizuar të studentëve dhe vendimet që kanë të bëjnë me disponimin dhe shfrytëzimin e resurseve financiare merren pas marrjes së pëlqimit paraprak të Bordit Menaxhues.

(3) Senati:

1. Përgatit programet e studimit;
2. Nxjerr kriteret për avansimin dhe dhënien e gradave akademike për profesorë, hulumtues dhe bashkëpunëtor profesional;
3. Zgjedh mësimdhënësit, punëtorët shkencor dhe bashkëpunëtorët profesional;
4. Vendos që të revokojë titullin e një mësimdhënësi, punëtori shkencor apo bashkëpunëtori profesional;
5. Miraton programin e hulumtimit;
6. Përgatit kalendarin akademik dhe planin vjetor të punës;

7. Pranon temat e doktoraturës për programet e doktoratës të cilat në të ardhmen mundën të akreditohen në kuadër të Kolegjit;
8. Emëron tre anëtarë të komisionit për vlerësimin e temave të doktoraturës dhe gatishmërinë e kandidatit për të shkruajtur temën e doktoraturës;
9. Emëron tre anëtarë të komisionit për vlerësimin e gatishmërisë për mbrojtje të temës së doktoraturës;
10. Përgatit mendime profesionale për hulumtuesit e rinjë dhe vendos për kandidaturën e tyre;
11. Diskuton dhe vendos për mendimet e këshillit të studentëve në kuadër të kompetencave të tyre;
12. Emëron organet e punës për kryerjen e punëve në fushat e caktuara;
13. Monitoron cilësinë e arsimit dhe kërkimit shkencor;
14. Zbaton sistemin evropian të transferit të kredive;
15. Vendos për çështjet tjera në pajtim me ligjin, statutin dhe rregulloret tjera;
16. Zgjedh anëtarët e senatit të Kolegjit që përfaqësojnë disiplinat shkencore dhe profesionale të cilat janë kyçe për Kolegjin.

Neni 23

Format e vendim-marrjes së senatit

- (1) Senati i Kolegjit mban mbledhje të cilat mundën të mbahen edhe në distancë.
- (2) Senati merr vendime nëse në mbledhje ka kuorum prej më shumë se 1/2 të anëtarëve.

Neni 24

Përbërja e senatit

- (1) Senati i kolegjit emëron anëtarët e përhershëm dhe të nderit.
- (2) Fushëveprimi i punës, përbërja e tyre dhe përgjegjësitë e secilit komision apo organ të punës së senatit përcaktohen me akt të emërimit.

Neni 25

Mbledhjet e senatit

- (1) Mbledhjen e senatit mundet të thirret me kërkesë të rektorit, dekanëve ose së paku tre anëtarëve të senatit, bordit menaxhues apo këshillit të studentëve.
- (2) Mbledhjet e senatit gjithashtu ndjeken nga Sekretari i Kolegjit i cili nuk ka të drejtë vote.
- (3) Për mbledhjen e senatit mbahet procesverbali i cili nënshkruhet nga rektori, dekani apo sekretari i kolegjit.
- (4) Në mungesë të rektorit apo dekanit mbledhjen e senatit mundet t'a udhëheq një anëtar i autorizuar i senatit.

Neni 26
Komisionet dhe organet e punës së senatit

- (1) Senati i Kolegjit mundet gjatë veprimtarisë së vet të emërojë komisionet e përhershme dhe të nderit dhe organet e punës.
- (2) Fushëveprimi dhe përbërja e komisioneve apo organeve të punës përcaktohet me aktin për themelimin e tyre.

Neni 27
Bordi Menaxhues (Bordi)

Bordi është organi më i lartë qeverisës dhe ekzekutiv i Kolegjit. Të gjitha kontratat në lidhje me çështjet financiare dhe administrative dhe shpenzimet për Kolegjin, statutin e saj, vendimet për ndryshime organizative dhe institucionale të Kolegjit dhe njësisive të saj organizative, si dhe çdo kontratë ose e prokurimit që kalon vlerën 500 euro, duhet të konfirmohet paraprakisht nga Bordi. Për këtë arsye Kryetari i Bordit do të nënshkruajë me shkrim dekretet e Bordit Menaxhues si bazë për veprim të mëtejshëm nga Rektori, siç është përcaktuar në dekretin e Bordit.

Bordi Menaxhues i Kolegjit përbëhet nga anëtarët si në vijim:

- Prof. Dr. Edmond Hajrizi –Kryetar i Bordit Menaxhues

Në bazë të këtij statuti, Bordi do të ketë pushtet për të marrë vendimet si në vijim në emër të Kolegjit:

- Emërimi i të gjithë zyrtarëve të Kolegjit, *inter alia*, i Kryetarit dhe Nënkyetarit të Bordit Menaxhues, Rektorit, Prorektorit, Shefit të Njesisë së Kontabilitetit, Zyrës së Regjistrarit;
- Emërimi i udhëheqësve të divizioneve, fakulteteve, kolegjeve, shkollave, instituteve, departamenteve dhe kryesuesve të Kolegjit; ky emërim bëhet me shumicë votash varësisht nga të drejtat e pronësisë ndaj Kolegjit dhe programeve përkatëse të studimit apo projekteve të ndryshme që përcaktohen me aneks statut;
- Emërimi i gjithë personelit të administratës së Kolegjit;
- Emërimi i tërë stafit mësimdhënës dhe kërkimor të Kolegjit;
- Vendimet që ndërlidhen me aspektet financiare të përgatitura nga Zyra e Kontabilitetit;
- Vendimet për kontratat financiare dhe të biznesit të nevojshme për mësimdhënie, kërkim dhe aktivitete tjera të Kolegjit;
- Miratimi i të gjitha akteve të brendshme rregullative siç janë aktet nënligjore dhe aktet tjera të domosdoshme për implementimin e statutit dhe nxjerrja e kushteve të përgjithshme të punës së Kolegjit;

- Vendimet për themelimin dhe implementimin e programeve të tjera të Kolegjit, siç janë programet kërkimore, projektet evropiane dhe të tjerat.

A. Vendimet që merren me koncensus nga Bordi Menaxhues janë:

- Vendimet për themelimin, akreditimin dhe licencimin e programeve të reja të studimit apo reformimit të programeve ekzistuese;
- Vendimet për shitjen e pronës, patundshmërive, pajisjeve teknike dhe logjistikës tjetër e cila nevojitet për zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe të tjera të Kolegjit;
- Vendimet për lidhjen e kontratave dhe implementimin e kontratave ndërkombëtare të projekteve ndërkombëtare bashkëpunuese të Kolegjit;
- Vendimet për statusin juridik të Kolegjit dhe njësive të saj organizative;
- Apo vendimet tjera që kanë të bëjnë me aktivitetet e regjistruara të Kolegjit;
- Emërimi i Shefit të Zyrës Sllovene të Kolegjit;
- Emërimi i Drejtorit;
- Vendimet për balansin e të ardhurave dhe shpenzimeve në fund të secilit vit ku vendoset se çka do të bëhet me profitin e Kolegjit dhe programeve apo projekteve të caktuara.

Neni 28

Përgjegjësitë e Kryetarit të Bordit Menaxhues

Kryetari i Bordit Menaxhues është përgjegjës të:

- Thërras mbledhjet e Bordit Menaxhues;
- Përcaktojë rendin e ditës së Bordit Menaxhues;
- Kryesojë mbledhjet e Bordit Menaxhues;
- Formulojë vendimet e Bordit Menaxhues;
- Mbikëqyr implementimin e të gjitha vendimeve;
- Përpilojë procesverbalin e Bordit Menaxhues, i cili nënshkruhet nga Kryetari i Bordit Menaxhues.

Kryetari i Bordit Menaxhues zgjedhet për pesë vjet.

Neni 29

Këshilli akademik

- (1) Këshilli Akademik përbëhet nga i gjithë stafi akademik i Kolegjit me një kontratë të vlefshme me Kolegjin në vitin aktual shkollor. Këshilli Akademik zgjedh anëtarët e Senatit dhe mbikëqyr aktivitetet e saj.

Këshilli akademik:

1. Zgjedh anëtarët e senatit në pajtim me dispozitat e statutit të kolegjit;
2. Jep udhëzime të përgjithshme senatit për programet e studimit dhe me implementimin e tyre;
3. Shqyrton raportet e punës së institucioneve të arsimit të lartë;
4. Kryen detyrat tjera të specifikuara në këtë statut dhe rregulloret e kolegjit;
5. Shqyrton raportet mbi punën e institucionit të arsimit të lartë;
6. Kryen detyrat tjera siç specifikohen me statut dhe rregulloret tjera të kolegjit.

(2) Këshilli akademik vendos në mbledhje që munden të mbahen edhe në distancë.

(3) Mbledhjet e Këshillit Akademik i udhëheq kryetari i cili zgjedhet nga mesi i anëtarëve të këshillit akademik.

Neni 30

Rektori

(1) Rektori është kreu akademik dhe shkencor i Kolegjit.

(2) Rektori është kompetent të kryejë detyrat si në vijim:

- Të përfaqësojë Kolegjin si institucion akademik;
- Të udhëheq, mbikëqyr dhe koordinojë studimet, hulumtimin dhe programet tjera akademike, projektet dhe njësitë e Kolegjit;
- Të mbikëqyr dhe koordinojë punën e njërive akademike të Kolegjit siç janë divizionet, departamentet, shkollat, fakultetet, kolegjet, libraritë dhe të tjera;
- Të ftojë dhe kryesojë seancat e senatit;
- Të bëjë propozime, nisma dhe opinione këshilldhënëse Bordit Menaxhues në çështjet akademike që ndërlidhen me personelin akademik të Kolegjit.

Neni 31

Dekani

(1) Bordi mundet të emërojë një apo më shumë dekanë.

(2) Dekani ndihmon Rektori me kërkesën e tij në detyrat e specifikuara nga Rektori në pajtim me Bordin.

(3) Dekani mund të zëvendësojnë Rektorin në mungesë të tij në qoftë se kështu është autorizuar nga Rektori ose nga Bordi.

(4) Dekani ndihmon rektorin në implementimin e vendimeve të cilat i sjell bordi menaxhues dhe udhëheq në mënyrë të pavarur njësitë e kolegjit të cilat implementojnë programet e studimit të Kolegjit.

- (5) Dekani kryen detyrat të cilat ndërlidhen me detyrat pedagogjike, studimore dhe ato që ndërlidhen me çështjet studentore në pajtim me rektorin.
- (6) Dekani i cili udhëheq me njësitë organizative të kolegjit është përgjegjës për realizimin e programeve dhe projekteve të Kolegjit.
- (7) Dekani është gjithashtu edhe kryetar i komisionit për studime.
- (8) Kolegji ka edhe dekanë tjerë për njësitë tjera organizative dhe për fushat tjera të veprimtarisë së Kolegjit.

Neni 32 **Këshilli i Dekanëve**

- (1) Këshilli i Dekanëve është një organ këshilldhënës i rektorit dhe dekanëve përkatës i cili trajton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me udhëheqjen e kolegjit. Këshilli i Dekanëve përbëhet nga rektori, dekani dhe sekretari i Kolegjit.
- (2) Rektori apo dekani thërret mbledhjet e Këshillit të Dekanëve në të cilat janë të ftuar dekanët, sekretari i Kolegjit, anëtarët e Bordit Menaxhues dhe sipas nevojës edhe përfaqësuesit e njësive tjera organizative të Kolegjit dhe përfaqësuesit e Këshillit të Studentëve.

Neni 33 **Bordi Ndërkombëtar Këshilldhënës**

- (1) Bordi do të emërojë Kryetarin dhe anëtarët e Bordit Këshilldhënës Ndërkombëtar të Kolegjit nga personalitete të statusit të lartë akademik dhe publik në bashkësinë ndërkombëtare relevante për Republikën e Kosovës dhe Republikën e Sllovenisë.
- (2) Bordi Ndërkombëtar Këshilldhënës duhet të ketë së paku nëntë (9) anëtarë.
- (3) Bordi Ndërkombëtar Këshilldhënës do të japë mendime me iniciativën e vet ose me kërkesë të Bordit, Senatit ose Rektorit të Kolegjit për çështjet e rëndësisë ndërkombëtare akademike dhe publike për Kolegjin.
- (4) Bordi do të përmbushë detyrat e tij në seancat e rregullta dhe me korrespondencë, të thirrura nga kryetari së paku një herë në vit.

Neni 34

Përbërja e Këshillit të studentëve

- (1) Këshilli i Studentëve përbëhet nga përfaqësuesit e studentëve. Këshilli i studentëve shqyrton dhe jep mendimet organeve drejtuese të Kolegjit mendimet e tij për statutin dhe aktet tjera nënligjore të Kolegjit të cilat prekin interesat e studentëve.
- (2) Nëse mendimi i Këshillit të Studentëve nuk respektohet nga organi përkatës atëherë Këshilli i Studentëve ka të drejtë që të kërkojë nga organi përkatës që të merr vendim për çështjen përkatëse. Vendimi duhet të merret me 2/3 e votave të organeve përkatëse.
- (3) Këshilli i Studentëve ka më së paku 4 anëtarë.
- (4) Mandati i anëtarëve të Këshillit të Studentëve është dy vjet.

Neni 35

Zgjedhja dhe mandati i anëtarëve të Këshillit

- (1) Anëtarët e Këshillit të Studentëve zgjedhen nga studentët me zgjedhje direkte. Zgjedhjet do të mbahen javën e dytë të tetorit. Mënyra e thirrjes së zgjedhjeve, procedura e kandidimit dhe procedura e zgjedhjeve do të përcaktohet me rregullore mbi zgjedhjet e këshillit të studentëve.
- (2) Rregullorja mbi zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Studentëve do të miratohet nga vetë Këshilli i Studentëve.

Neni 36

Forma e veprimit të Këshillit të Studentëve

- (1) Këshilli i Studentëve vendos në mbledhje të cilat janë publike. Vendimi merret me shumicë të votave të anëtarëve prezent. Së paku 2/3 e anëtarëve të Këshillit të Studentëve duhet të jenë të pranishëm.
- (2) Këshilli i Studentëve udhëhiqet nga Kryetari të cilin studentët e zgjedhin vetë nga rradhët e Këshillit. Në mungesë të tij/saj mbledhjen e udhëheq nënkryetari të cilin e zgjedhin vetë anëtarët e Këshillit të Studentëve.
- (3) Në mbledhjet e Këshillit të Studentëve mbahet procesverbali që mbahet nga një anëtar i Këshillit të Studentëve dhe nënshkruhet nga kryetari i Këshillit të Studentëve.

Neni 37

Komisioni për habilitim/tituj akademik

- (1) Komisioni për habilitim/tituj akademik është organ punues i senatit të Kolegjit ESLG.

- (2) Komisioni për habilitim/tituj akademik jep mendime për thirrjen akademike të një mësimitdhënësi, punëtori shkencor dhe bashkëpunëtori profesional.
- (3) Komisioni për habilitim/tituj akademik jep mendim për revokimin e thirrjes akademike të dhënë sipas paragrafit 2 të këtij neni.
- (4) Komisioni për habilitim/tituj akademik përbëhet nga së paku pesë anëtarë të cilët senati i fakultetit i zgjedh nga rradhët e mësimitdhënësve.

Neni 38 **Mandati i Komisionit**

- (1) Mandati i anëtarëve të komisionit të habilitimit zgjat tre vjet.
- (2) Anëtarët e komisionit të habilitimit zgjedhin kryetarin nga rradhët e veta i cili udhëheq me mbledhjet e këtij komisioni.

Neni 39 **Vendimet e Komisionit**

Komisioni për habilitim merr vendime nëse në takim janë shumica e anëtarëve të tij dhe vendimet e tij i merr me shumicë absolute të anëtarëve të komisionit.

Neni 40 **Komisioni i Studimeve**

Komisioni për studime:

- Miraton temat e diplomës dhe temat e magistraturës dhe cakton mentorin përkatës për një kandidat;
- Emëron komisionin profesional për vlerësimin e temës së diplomës dhe temën e diplomës master;
- Propozon senatit komisionin për vlerësim të temës master;
- Vendos për pranimin e studentëve dhe kalimin e tyre prej një viti në vitin tjetër akademik;
- Me kërkesë të studentit jep mendim të arsyetuar për përparimin urgjent të një studenti

Neni 41 **Programet e studimit**

- (1) Senati i Kolegjit ESLG vendos për programet e studimit të cilat do të jepen pranë këtij kolegji. Kolegji duhet të akreditojë programet e studimit pranë Agjencisë Akreditimit të Kosovës apo agjencive të akreditimit të vendeve tjera.
- (2) Për secilin program të studimit student duhet të përmbush të gjitha kërkesat e parapara me atë program dhe të cilat rezultojnë me marrjen e një diploma akademike.

Neni 42
Komisioni Disciplinor

- (1) Komisioni Disciplinor trajton rastet e shkeljes së rregullave të provimit dhe vendos për shqiptimin e dënimeve.
- (2) Komisioni Disciplinor përbëhet nga dy anëtarë dhe kryetari. Anëtarët e Komisionit Disciplinor emërohen nga Bordi Menaxhues për mandat tre vjeçar.
- (3) Dekani vendos për iniciimin e procedurës disiplinore. Kundër vendimit të Komisionit Disciplinor pala e pakënaqur ka të drejtë të bëjë ankesë në Senat. Procedurat e komisionit disiplinor rregullohen me rregulloren për studime.

Neni 43
Komisioni për Cilësi

- (1) Anëtarët e Komisionit për Cilësi emërohen nga senati i Kolegjit me propozim të Rektorit apo dekanit. Ky Komision përbëhet nga së paku 6 anëtarë, kryetari i të cilit emërohet nga ana e senatit.
- (2) Komisioni për Cilësi përfaqësohet nga të gjitha palët kryesore të interesit si profesorët, hulumtuesit, studentët, stafi profesional, stafi administrativ dhe bashkëpunëtorët profesional.
- (3) Komisioni për Cilësi kryen detyrat si në vijim:
 1. Përgatit raportet vjetore për cilësi (raportin e vetëvlerësimit);
 2. Bën monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së studimeve dhe rekomandon përmirësimet e tyre;
 3. Bën monitorimin e vazhdueshëm të punës kërkimoro-shkencore dhe jep propozime për përmirësimin e saj;
 4. Kryen detyra të tjera me qëllim të përmirësimit të cilësisë të cilat rregullohen me Rregulloren për Cilësi;
 5. Funksionimi i detajuar i Komisionit për Cilësi rregullohet me Rregulloren për Cilësi të Kolegjit ESLG;

Neni 44
Zyra e Regjistrarit

Zyra e regjistrarit kryen detyrat administrative dhe teknike të Kolegjit. Udhë heqës i zyrës së regjistrarit është sekretari/ja e Kolegjit e cila i përgjigjet rektorit, dekanit dhe kryetarit të Bordit Menaxhues. Sekretari i Kolegjit emërohet nga Kryetari i Bordit Menaxhues me mandat tre vjeçar me mundësi vazhdimi.

Sekretari i Kolegjit kryen detyrat administrative dhe teknike në kë to fusha:

1. Çështjet studentore;
2. Regjistrimin në studime në Kolegj;
3. Punën hulumtuese;
4. Kë rkesat e studentëve;
5. Çështjet financiare;

6. Bashkëpunimi ndërkombëtar;
7. Çështjet kadrovike dhe juridike;
8. Aktivitetet botuese;
9. Çështjet protokolare;
10. Çështjet tjera;

Neni 45

Zyra e kontabilitetit

Shefi i kontabilitetit të universitetit është shefi i zyrës së kontabilitetit, i cili është përgjegjës për administrimin e financave në përgjithësi, mirëmbajtjen e librave të kontabilitetit të universitetit dhe njësive të tij, analizimi i gjendjes financiare të universitetit dhe njësive të tij dhe mbajtja e kontabilitetit dhe nxjerrja e raporteve financiare.

Neni 46

Asetet e Kolegjit

- (1) Asetet e Kolegjit dhe mjetet tjera financiare janë pronë e themeluesve.
- (2) Kolegji menaxhon me asetet e Kolegjit dhe të mirat që fitohen nga qarkullimi financiar i Kolegjit dhe për këtë i përgjigjet themeluesve.
- (3) Kolegji është përgjegjës për qarkullimin juridik me asetet të cilat disponon.
- (4) Kolegji menaxhon me asetet e njësive individuale duke mbajtur pasqyra të veçanta financiare për to. Për këtë vendos Bordi Menaxhues me akt të themelimit të njësive të veçanta organizative.

Neni 47

Burimet e financimit

Burimet e financimit të Kolegjit janë :

1. Nëpërmjet të konkurrimit në tenderët publik të shtetit;
2. Pagesës së shkollimit;
3. Kapitali aksionar i themeluesve;
4. Pagesat e punëve konsulente;
5. Nga pjesëmarrja në projektet vendore dhe ndërkombëtare hulumtuese dhe të konsulencës;
6. Donacionet dhe dhuratat tjera;
7. Burimet tjera;

Neni 48
Përgatitja e programeve të studimit

- (1) Zhvillimin e programeve të reja të studimit e sugjeron Senati i Kolegjit në pajtim me Bordin Menaxhues të Kolegjit.
- (2) Arsimi i lartë kryhet nëpërmjet të programeve të studimit të cilat i përgatit senati. Kolegji duhet të akreditojë programet e studimit pranë Agjencisë Kosovare të Akreditimit dhe agjencitë tjera ndërkombëtare për akreditim.
- (3) Pas kryerjes me sukses të programeve të studimit, kandidati merr diplomën e cila është dokument publik.

Neni 49
Programet e përbashkëta të studimit

Kolegji ESLG jep programet e studimit në mënyrë të pavarur apo në bashkëpunim me institucionet tjera të arsimit të lartë në vend apo jashtë vendit në formë të programeve të përbashkëta të studimit.

Neni 50
Programet e studimit

Kolegji zhvillon dhe pretendon të zhvillojë këto programe të studimit:

1. Programe të studimeve themelore bachelor;
2. Programe të studimeve pasdiplomike master;
3. Programe të studimeve të doktoratës

Neni 51
Grada akademike

- (1) Studenti i cili përfundon me sukses të gjitha kërkesat e parapara për studimet themelore fiton titullin bachelor
- (2) Studenti i cili përfundon me sukses të gjitha kërkesat e parapara për studimet pasdiplomike fiton titullin master.
- (3) Studenti i cili përfundon me sukses të gjitha kërkesat e parapara për studimet e doktoratës fiton titullin doktor në shkencat përkatëse.

Neni 52
Përbërja e programeve të studimit

- (1) Programet e studimit i zhvillon Kolegji.
- (2) Pjesët përbërëse të një programi të studimit janë:
 1. Të dhënat e përgjithshme mbi programin (emri, niveli, lloji, kohëzgjatja);
 2. Qëllimet kryesore të programit dhe kompetencat e programit;

3. Të dhënat për aplikueshmërinë ndërkombëtare të programit;
4. Të dhënat për bashkëpunimin ndërkombëtar të kolegjit;
5. Të dhënat për caktimin e kredive ECTS për lëndët përkatëse;
6. Kushtet për regjistrim;
7. Kushtet për njohjen e njohurive dhe shkathtësive të fituara para regjistrimit në program;
8. Llojet e vlerësimit;
9. Kushtet e përparimit në kuadër të programit
10. Kushtet për transfer ndërmjet të programeve;
11. Lloji dhe format e kryerjes së studimeve;
12. Kushtet për përfundimin e studimeve;
13. Kushtet për fitimin e titullit shkencor.

Neni 53

Detyrimet e studimeve dhe kohëzgjatja

- (1) Programi i studimit duhet të ketë së paku 60 kredi ECTS në kuadër të një viti akademik.
- (2) Programi i studimit i nivelit bachelor duhet të ketë së paku 180 ECTS kredi i cili zgjat më së paku tre vjet.
- (3) Programi i studimit i nivelit master duhet të ketë së paku 120 ECTS kredi i cili zgjat më së paku dy vjet.
- (4) Programi i studimit i nivelit të doktoratës duhet të ketë së paku 180 ECTS kredi i cili zgjat më së paku tre vjet.
- (5) Programet e studimit janë një formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe janë të dizajnuara për të plotësuar, thelluar dhe përditësuar e njohuritë e studentë ve.

Neni 54

Format tjera të arsimimit

- (1) Kolegji përveç programeve të arsimimit formal gjithashtu organizon forma të ndryshme të arsimimit joformal si kurse, shkolla verore, programe të aftësimi dhe të tjera me kusht që kjo nuk pengon në implementimin e programeve të studimit të cilat rezultojnë me marrjen e kualifikimit.
- (2) Programet e arsimimit të përmendura më lartë miratohen nga senati.

Neni 55

Fitimi i kredive nëpërmjet të kryerjes së praktikës

- (1) Në programin e studimeve bachelor studentit mundet në bashkëpunim me bartësin e lëndës t'i njihet praktika e punës së kryer në vlerë prej më së paku 10 kredi ECTS e më së shumti 12 ECTS.
- (2) Studentit mundet në bashkëpunim me bartësin e lëndës t'i njihet praktika e punës në formë të punimeve seminarike të cilat arrijnë vlerën prej 2 deri në 4 ECTS kredi.

Neni 56

Kushtet e regjistrimit në Kolegj

Kushtet e regjistrimit, procedura e regjistrimit dhe kriteret e përzgjedhjes rregullohen me programet e studimit veç e veç, konkursin për regjistrim të studentëve dhe rregulloren për studime.

Neni 57

Studimet e rregullta dhe korrespondencë

Studimet zhvillohen në formë të rregullt dhe me korrespondencë.

Neni 58

Studimet me korrespondencë

- (1) Studimet organizohen si studime me korrespondencë nëse kushtet e kolegjit e lejojnë këtë dhe nëse programi i studimeve është i natyrës së tillë që e lejon këtë.
- (2) Studimet me korrespondencë zhvillohen si studime në distancë gjithashtu.
- (3) Studenti mundet të regjistrohet shumë lehtë nga studimet me korrespondencë në të rregullt dhe anasjelltas.

Neni 59

Barazvlera e studimeve të rregullta dhe atyre me korrespondencë

- (1) Studimet me korrespondencë për nga karakteristikat dhe kërkesat duhet të jenë të njëjta me ato të rregullta.
- (2) Studenti me korrespondencë mundet shumë lehtë që të regjistrohet nga studimet me korrespondencë në studimet e rregullta. Studentët e studimeve të rregullta mundën shumë lehtë të regjistrohen në studimet me korrespondencë. Kushtet dhe procedura e regjistrimit dhe transferit prej një forme në tjetrën rregullohen me Rregulloren për Pranimin dhe Transferin e Studentëve në Studimet Bachelor dhe Rregulloren për Pranimin dhe Transferin e Studentëve në Studimet Master.

Neni 60

Studimet paralele

- (1) Studimet paralele janë studimet të cilat studenti mundet t'i ndjek paralelisht në disa programe të studimit. Studenti i cili kryen me sukses obligimet e të gjitha programeve të studimit merr diplomën përkatëse nga secili program i kryer në formë paralele.
- (2) Studenti gjithashtu pas përfundimit me sukses të vitit të parë në një program të studimeve mundet të regjistrohet në mënyrë paralele në programin tjetër të studimeve, nëse për programin tjetër plotëson kushtet për regjistrim.

Neni 61

Studimet interdisciplinare

- (1) Studimet interdisciplinare munden të kryhen nga disa institucione të arsimit të lartë ku secila prej tyre është përgjegjëse për fushën e tyre të studimit.
- (2) Me një akt të brendshëm rregullativ apo marrëveshje të veçantë rregullohen aspektet e regjistrimit, ofrimi i ligjëratave dhe aktivitetet tjera të karakterit pedagogjik, provimet dhe mbajtja e evidencës, mentorimi i temave të diplomës dhe shpenzimet materiale dhe të ndryshme të cilat lindin nga zbatimi i programit interdisciplinar.

Neni 62

Studimet individuale

Studimet individuale janë ato studime për të cilat organizohen aktivitete pedagogjike (ligjëratat, ushtrimet dhe punimet seminarike) nëpërmjet të konsultimeve individuale me studentët. Kjo formë e studimeve organizohet veçanërisht nëse një numër i vogël i studentëve regjistrohet në kuadër të programit.

Neni 63

Transferi ndërmjet të programeve të studimeve

- (1) Transferi ndërmjet të programeve të studimit është i mundshëm pas kryerjes së një programi të studimit dhe vazhdimit në programin tjetër të studimeve.
- (2) Programi i parë studimor është program nga i cili vjen studenti. Programi i parë studimor mund të përfshijë të gjitha programet e studimit të të njëjtit nivel në të cilin kandidati ka plotësuar tashmë kushtet akademike dhe mund të njihet në një tjetër program studimi. Programi i dytë studimor është një program në të cilin studenti kalon.
- (3) Aplikantët për transferim nga njëri program në tjetrin kryejnë procedurat nëpërmjet të sistemit online. Kolegji organizon procesin e transferit.
- (4) Kushtet e regjistrimit dhe të transferit rregullohen me konkursin për regjistrim dhe rregulloren për studim.

Neni 64
Gjuha e studimeve

Gjuha e studimeve është gjuha shqipe dhe angleze. Nëse ligji e lejon këtë gjë programi i studimeve mundet të zhvillohet edhe në ndonjë gjuhë tjetër.

Neni 65
Viti i studimeve

- (1) Viti i studimeve fillon më 01 tetor dhe përfundon me 30 shtator të vitit tjetër;
- (2) Viti i studimeve mundet të organizohet në trimestra apo semestra.

Neni 66
Gjuha e punimeve të diplomës bachelor dhe master

Punimet e diplomës bachelor dhe master mund të përpilohen në gjuhën shqipe apo angleze.

Neni 67
Fushëveprimi i ligjëratave

- (1) Detyrimet javore për programet e studimeve bachelor shtrihen nga 20 deri në 30 orë në javë ligjë rata, ushtrime, detyra, seminare dhe obligime të tjera për 30 javë që i përmban viti akademik.
- (2) Nëse në kuadër të programit të studimeve regjistrohen një numër i vogël i kandidatëve, procesi mësimor mundet të organizohet nëpërmjet të konsultimeve individuale. Për këtë vendos Bordi Menaxhues i Kolegjit.
- (3) Nëse një program studimi përfshin trajnim praktik, ngarkesa totale e studentit nuk guxon të tejkalojë normën prej 40 orë në javë dhe 42 javë në vit.

Neni 68
Format e vlerësimit të njohurisë

- (1) Suksesi i studentit në kryerjen e detyrimeve të një programi të studimeve kryhet nëpërmjet të vlerësimit të njohurive të fituara dhe procesit të notimit. Format e vlerësimit të njohurive janë provimet, testet, esetë, punimet hulumtuese dhe format tjera të vlerësimit.
- (2) Format e mbajtjes së provimeve, afatet e provimeve dhe kushtet tjera të ekzaminimit dhe aspektet tjera të vlerësimit rregullohen me Rregulloren për Studime të Kolegjit ESLG dhe Rregulloren për Vlerësim dhe Administrim të Provimeve të Kolegjit ESLG.

Neni 69

Pranimi i provimeve dhe detyrimeve tjera studimore të kryera në institucionet tjera të arsimit të lartë

- (1) Studentët që përpara regjistrimit në Kolegjin ESLG kanë kryer provimet dhe detyrimet tjera të programeve të studimit të kryera në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë dhe jashtë vendit mundën të parashtrojnë kërkesë për pranimin e provimeve.
- (2) Kushtet dhe procedura e pranimit të provimeve rregullohet me Rregulloren për Studime.

Neni 70

Kalimi në vitin më të lartë

Studenti mundet të regjistrohet në vitin më të lartë nëse ka kryer të gjitha obligimet e programit të studimeve dhe kushtet për kalim në vitin tjetër të studimeve. Kushtet për përparim në vitin më të lartë të studimeve, përsëritjen e vitit dhe regjistrimin e kushtëzuar rregullohen me rregulloren për studime.

Neni 71

Regjistrimi i jashtëzakonshëm

- (1) Regjistrimi i jashtëzakonshëm në vitin tjetër mund të bëhet edhe nëse studenti nuk ka përmbushur kushtet për avansim në vitin tjetër të studimeve nëse për këtë posedon një arsye të bazuar.
- (2) Arsyeja e bazuar me të cilën studenti regjistrohet në formë të jashtëzakonshme në vitin tjetër të studimeve është: pushimi i lehonisë, sëmundja e cila ka zgjatur më shumë se dy muaj, pjesëmarrja në aktivitetet e ndryshme profesionale, kulturore dhe sportive, pjesëmarrja aktive në organet e Kolegjit apo pjesëmarrja në aktivitetet shoqërore të rëndësishme nga të cilat ka dobi tërë shoqëria. Këto arsye studenti duhet t'i dë shmojë me dokumente të besueshme.
- (3) Përparimi në vitin tjetër të studimeve pa përmbushur të gjitha detyrimet studimore të vitit paraprak është i mundur nëse për këtë vendos Komisioni për Studime. Për këtë studenti duhet të parashtrojë kërkesë deri më 20 shtator të vitit përkatës.

Neni 72
Përsëritja e vitit

- (1) Studentët të cilët nuk kanë përfunduar të gjitha obligimet e parashtruara nga programi studimor për regjistrim në vitin e ardhshëm mund të përsërisin vitin e studimeve vetëm një herë dhe brenda këtij viti duhet të përmbushin detyrimet për kalim në vitin e ardhshëm të studimeve.
- (2) Kërkesën për përsëritje të vitit studenti duhet t'a bëjë deri më 20 shtator të vitit përkatës.

Neni 73
Regjistrimi i kushtëzuar

Studenti mundet të bëjë regjistrim me kusht në vitin e ardhshëm të studimeve nëse ka një detyrim më pak se që parashihet me Rregulloren e Studimeve për kalimin në vitin e ardhshëm të studimeve.

Neni 74
Kushtet për përparim më të shpejtë

- (1) Studenti i cili gjatë studimeve tregon rezultate të shkëlqyeshme të studimeve mundet të përparojë më shpejtë gjatë procesit të studimeve.
- (2) Studentit i mundësohet përparimi më i shpejtë nëse ai/ajo tregon sukses të shkëlqyeshëm në përmbushjen e detyrimeve mësimore dhe nëse ai ka dhënë të gjitha provimet nga viti paraprak duke arritur notën mesatare më së paku prej tetë.
- (3) Vendimin për këtë e nxjerr senati pas kërkësës së kandidatit dhe pas arsyetimit të dhënë nga Komisioni për Çështje Studimore. Në vendim specifikohet mënyra e përparimit më të shpejtë gjatë procesit të studimeve.

Neni 75
Vazhdimi i studimeve pas ndërprerjes

Ndërprerja e studimeve llogaritet nga dita kur studenti ka humbur statusin e studentit. Humbja e statusit të studentit rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Rregulloren e Kolegjit.

Neni 76
Ndërprerja e studimeve

Ndërprerja e studimeve dhe procedurat për vazhdim të studimeve rregullohen me rregulloret e Kolegjit.

Neni 77
Ndërprerja me më shumë se dy vjet

- (1) Nëse më shumë se dy vjet kalojnë nga momenti i ndërprerjes së studimeve nga ana e studentit, studentit duhet të bëjë kërkesë për vazhdim të studimeve pranë Komisionit për Studime. Në rast të vendimit pozitiv të Komisionit për Studime, në vendim specifikohet mënyra e vazhimit të studimeve, mënyra e dhënies së provimeve, punimeve seminarike dhe temës së diplomës, afati për përfundimin e studimeve dhe mënyra e pagesës së pjesës së mbetur të shkollimit në pajtim me listën e pagesave të shkollimit të Kolegjit.
- (2) Në rast se pas ndërprerjes së studimeve nga ana e studentit ndryshon planprogrami, atëherë Komisioni për Studime merr vendim për provimet diferenciale të cilat studentit duhet t'i jap si detyrime shtesë të lindura si kusht për vazhdimin e studimeve.
- (3) Nëse para pezullimit të studimeve studentit ka pasur obligime të dhënies së provimeve shtesë përpos atyre diferenciale, atëherë Komisioni për Studime përpos dhënies së provimeve diferenciale të parapara me planprogramin e ri, parashikon edhe dhënien e provimeve të vjetra të cilat kanë qenë të aplikueshme me planprogramin e vjetër. Studenti më pastaj duhet që përsëri të paguajë kreditë ECTS të provimeve të mbetura por edhe të provimeve të reja diferenciale të parapara me planprogramin e ri.

Neni 78
Puna kërkimore-shkencore

- (1) Puna kërkimore dhe shkencore është bazë për zbatimin cilësor të aktiviteteve pedagogjike.
- (2) Përveç punës shkencore dhe kërkimore e cila është e lidhur drejtpërdrejt me procesin arsimor dhe pedagogjik të Kolegjit, Kolegji kryen gjithashtu punë kërkimore dhe shkencore në projektet tjera të porositura nga palët e treta në pajtim me ligjin dhe rregulloret e brendshme të cilat e rregullojnë aktivitetin kërkimoro-shkencor.

Neni 79

Mësimdhënësit, punëtorët shkencor dhe bashkëpunëtorët shkencor

- (1) Titujt e mësimdhënësve, punëtorëve shkencor dhe bashkëpunëtorëve shkencor të Kolegjit jepen në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë i cili rregullon veprimtarinë e kolegjeve.
- (2) Titujt e mësimdhënësve të parashikuar me ligjin për arsimin e lartë janë: 1) asistenti, 2) ligjëruesi, 3) profesori asistent dhe 4) profesori.
- (3) Bashkëpunëtorët shkencor janë: bashkëpunëtori shkencor, bashkëpunëtori i lartë shkencor dhe këshilltari shkencor.
- (4) Bashkëpunëtorët e arsimit të lartë janë: asistenti, bibliotekisti, këshilltari profesional, këshilltari i lartë profesional dhe bashkëpunëtori profesional.

Neni 80

Procedura për dhënien e titujve

- (1) Procesi pedagogjik në nivelin e studimeve bachelor dhe master mund të kryhen nga mësimdhënësit e parashikuar me titujt sipas nenit 81.
- (2) Procedura për dhënien e titullit të mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorit shkencor rezulton me vendim për dhënien e titullit të mësimdhënësit apo bashkëpunëtorit shkencor.
- (3) Senati i Kolegjit më së voni deri në 30 ditë pas marrjes së vendimit nga tre anëtarët e komisionit recenzent të cilët japin mendimin për aftësinë profesionale të kandidatit për t'ju dhënë titulli përkatës akademik. Raporti duhet t'i dorëzohet Komisionit për Habilitim.
- (4) Komisioni për Habilitim pas marrjes së raportit nga Komisioni Recenzues jep mendimin profesional për dhënien e titullit përkatës senatit të Kolegjit.
- (5) Nëse Komisioni për Habilitim mendon se kandidati nuk plotëson kushtet për të marrë titullin përkatës akademik të parashikuar me nenin 81 të këtij statuti dhe dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, atëherë ai i rekomandon senatit që kandidatit të mos i jepet titulli përkatës akademik.
- (6) Pas marrjes së mendimit pozitiv nga ana e komisionit për habilitim, senati i Kolegjit merr vendim për dhënien e titullit akademik të parashikuar me nenin 81 të këtij statuti.

(7) Kandidati ka të drejtë të bëjë ankesë kundër vendimit të senatit sipas Ligjit për Procedurën Administrative.

Neni 81
Vlefshmëria e titullit

Asistentët, ligjëruesit, profesorët asistent dhe profesorët zgjidhen për afat prej pesë vjetëve.

Neni 82
Rregullat për dhënien e titullit akademik

Kushtet për dhënien e titujve përkatës akademik të parashikuar me nenin 81 të këtij statuti rregullohen me Rregulloren për Habilitim dhe Dhënien e Titujve Akademik të Kolegjit ESLG.

Neni 83
Statusi i studentit

- (1) Studenti është kandidati i cili është pranuar në Kolegj sipas konkursit të shpallur dhe i cili i ka plotësuar kushtet e parashikuara me konkurs.
- (2) Statusi i studentit dëshmohet me dëshminë për regjistrim dhe kartelën e studentit.
- (3) Studenti i programeve të studimit të nivelit bachelor dhe master humb statusin e studentit në rastet e parashikuara me ligjin për arsimin e lartë .

Neni 84
Vërtetimet e studentëve

Kolegji në bazë të evidencave të veta, në pajtim me ligjin në fuqi për arsimin e lartë mundet të lëshojë këto dokumente:

1. Fletëregjistrimin;
2. Vërtetimin për paraqitje të provimit;
3. Certifikatën e notave;
4. Certifikatën e kryerjes së studimeve;
5. Diplomën.

Neni 85
Të drejtat dhe obligimet e studentëve

Studenti gëzon të drejtat dhe obligimet përkatëse të cilat parashikohen me ligjin për arsimin e lartë, aktet tjera nënligjore, këtë statut dhe aktet tjera të brendshme të Kolegjit.

Neni 86
Vetëqeverisja

Studentët nëpërmjet të përfaqësuesve të vet kanë të drejtë të marrin pjesë në organet e kolegjit.

Neni 87
Përgjegjësia disiplinore

Studentët bartin përgjegjësi disiplinore për shkeljet e detyrimeve dhe mosplotësimin e këtyre detyrimeve të cilat parashikohen me këtë statut dhe me rregullat e programeve të studimit. Kjo pjesë rregullohet me rregulloren për studime të cilën e nxjerr Bordi Menaxhues i Kolegjit.

Neni 88
E drejta për regjistrim dhe arsim të lartë

Studentët kanë të drejtë për regjistrim dhe arsim të lartë në bazë të kushteve të njëjta pa diskriminim siç parashikohet me Ligjin për Arsimin e Lartë, statutin e Kolegjit dhe me kushtet e regjistrimit të programit të studimeve.

Neni 89
E drejta për kundërshtim

- (1) Studenti ka të drejtë të bëjë kundërshtim kundër vendimeve të organeve të Kolegjit të cilat rregullojnë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre.
- (2) Studentët kanë të drejtë të bëjnë kundërshtim brenda 15 ditëve nga momenti i marrjes së vendimit me të cilën ata mendojnë se të drejtat e tyre janë cinguar.

Neni 90
Vendimi mbi kundërshtim

Për kundërshtimin e studentit vendos Dekani i Kolegjit brenda 15 ditëve nga momenti i pranimit të kundërshtimit.

Neni 91
Ankesa

Studenti ka të drejtë të bëjë ankesë kundër vendimit të dekanit pranë zyrës së Rektorit të Kolegjit brenda 15 ditëve pas pranimit të vendimit të Dekanit.

Neni 92
Konflikti administrativ

Kundër vendimit të organit kompetent të Kolegjit, studenti ka të drejtë të inicojë procedurën administrative sipas Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Neni 93
Hyrja në fuqi

Ky statut i ndryshuar hyn në fuqi në momentin e shpalljes së saj në sistemin informativ të Kolegjit.

Prishtinë, më 14 GUSHT 2019.

Prof. Dr. EDMOND HAJRIZI, KRYETAR I BORDIT MENAXHUES

